



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINES
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr 06-10508 /2021

Klinë, 26. 02. 2021

PROCESVERBAL

I Seancës së rregullt, të punës së Kuvendit të Komunës të Klinës, mbajtur më 26. 02. 2021, filluar në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Seanca u organizua duke respektuar udhëzimet e IKSHPK.

Seancën e hapi kryesuesi I Kuvendit, z. Fadil Gashi I cili përshëndeti gjithë të pranishmit dhe I falënderoi për pjesëmarrje. Kryesuesi z. Gashi, falënderoj anëtarin më të vjetër të Kuvendit z. Zeqir Morina për udhëheqjen e seancës së kaluar, në mungesë të tij. Në emër të anëtarëve të Kuvendit, kryesuesi, përshëndeti kryetarin e Komunës, nënkyetar, drejtorët e drejtive, OSBE- përfaqësuesin e OSBE-së i cili është i pranishëm në sallë, OJQ-të, Radio "Alba", dhe gjithë zyrtarët e tjera prezent në sallë. Kryesuesi fillimisht informoi anëtarët e kuvendit se në tavolinat e tyre janë dorëzuar formularët e deklarimit të pasurisë dhe se afati rrjedh nga 1 marsi. Ai luti anëtarët e Kuvendit që të plotësojnë formularët dhe të i dorëzojnë ato sipas kërkësës ligjore.

Kryesuesi propozoj që për rendin e ditës përvèç pikave që janë përcaktuar , me propozimin e drejtorisë së shërbimeve publike të futet edhe pika shtesë , ajo e shqyrtimit dhe aprovimit të zonës së veçantë të një parcele, pronë private e cila ka numrin e kadastrit dhe informacionet e nevojshme. Ku planifikohet të ndërtohet një rezervuar i ujit. Hapet debat për rendin e ditës duke konstatuar se prezent në sallë janë 25 anëtarë.

z. Gjokë Lleshaj: Përshëndetje të gjithëve. Dua të bisedoj pak për rendin e ditës . Kam be një kërkësë kohë të gjatë dhe përkundër zotimit të kryetarit për sjelljen e një rapporti për ndihmat e ndara. Mezi ka ardhur në këtë seancë si pikë e rendit të ditës por edhe tash ka ardhur gjysmak. (ndërhyjnë kryesuesi i Kuvendit dhe kërkon që të mos vazhdohet me tej pasi që kjo çështje është në rendin e ditës dhe do të diskutohet kur të vije ajo pikë e gjithashtu z. Lleshaj do ta ketë tërë kohen e dëshiruar. Me këtë pajtohet edhe z. Lleshaj dhe e ndërprenë debatin.)

z. Enver Berisha: Përshëndetje të gjithëve. E ndjeja obligim me dalë para juve dhe kolegëve këtu në foltore për shkakun se ju nuk keni qenë në seancën e kaluar në udhëheqje të asamblesë komunale. Dy janë çështjet që dëshiroj të i bisedoj. E para është për një vendim të nxjerra mbi kërkesën e një punëtoreje të komunës sonë për ndihmë financiare dhe paraprakisht kemi pasur një qëndrim se është mirë të mbështetet të gjithë punëtorët e komunës që kanë nevojë me mundësitë që ka komuna. Ajo që dua të them e që veç se ka bërë jehonë të qëllimshme nga dikush është thënë në opinion pas kuvendit se Enver Berisha dhe anëtarët e PDK-së kanë qenë kundër që të i ndihmohet punëtores në fjalë. Kjo le të dihet publikisht që nuk është e vërtetë dhe të gjithë e dimë që vota ime dhe e grüpuit të PDK-së ka qenë pro vendimit për ndihmë punëtores në fjalë. E dyta, bashkërisht jemi dakorduar që në seancën e janarit të trajtohet çështja e COVID-19 dhe të ndahen mjetet për të prekurit me Covid. Ju në atë seancë nuk keni qenë dhe ajo pikë ka rënë poshtë me vendimin e partive në pushtet. Krejt këtë e theksova me qellim të korrektësisë ndaj juve sepse ne bashkërisht jemi dakorduar në KPF që kjo çështje të trajtohet dhe të vendoset për një shumë në ndihmë të të prekureve me covid në komunën tonë. Përsëri insistoj që nëse jo në këtë seancë, në seancën e radhës ose në një seancë të jashtëzakonshme të thirru nga ne të trajtohet kjo çështje. Për arsyen se po krijohet përshtypje se më shumë po kanë rëndësi projektet infrastrukturore se sa jeta e njerëzve. E ne jemi pikërisht këtu për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi e vuri në votim rendin e ditës me propozimin e dhënë nga ai në fillim të kësaj seance dhe me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Kryesuesi i kuvendit theksoi se kur e konfirmoj prezencën e anëtarëve të kuvendit se mungojnë Baki Gashi dhe Agustin Selamanj i cili është rrugës duke ardhur. Pra në sallë janë prezent 25 anëtarë të kuvendit.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi edhe në këtë pikë të rendit të ditës fjalën jua dha anëtarëve të kuvendit që të shprehin vërejtjet ose plotësimet e tyre në procesverbal por nuk kishte asnjë vërejtje, përmirësim apo plotësim dhe pasi u vendos në votim, me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i rekomandimeve të KPF-së

Kryesuesi theksoi se një pjesë e rekomandimeve janë në rend dite prandaj a pajtoheni që të i aprovojmë në pak. U vendos në votim dhe me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN rekomandimet e KPF-së.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit finanziar janar-dhjetor 2020

Këtë pikë të rendit të ditës referon Drejtoria për Financa, ekonomi dhe zhvillim

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Përshtendetje të gjithëve. Në fillim të këtij prezantimi dua të theksoi se viti 2020 ka qenë një ndër vitet më të vështira edhe në kuptimin buxhetore për shkak të covid 19. Lirisht mund të them se gjatë vitit 2020 jemi kthyer mbrapa nga aspekti buxhetor në fund të vitit 2017 apo fillimin e vitit 2018. Për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar – dhjetor 2020 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, do të analizojmë disa tende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë

	Buxheti në SIMF 2020	% në total	Buxheti sipas SIMFK 2019	Ndryshimi nga 2019 në %
Granti qeveritar	10,421,155.80	88.92%	9,190,774.62	13.4%
Të hyrat vetanake 2019	915,074.00	7.80%	1,144,244.10	-20%
Të hyrat e bartura	361,621.56	3.08%	298,998.53	20.9%
Participimi i qytetarve	22,234.86	0.19%	13,311.46	67%
Save the Children	0.00	0.00	15,786.12	-100%
Qeveria Zvicerane	0.01	0.00	0.01	0.00
TOTALI :	11,720,086.23	100%	10,440,014.74	12.26 %

periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Raporti për periudhën janar-dhjetor 2020, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafet 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

TË HYRAT BUXHETORE TË KOMUNËS SË KLINËS Për periudhën janar- dhjetor 2020

Tabela 1. Buxheti në SIMFK për vitin 2020 sipas burimit dhe krahasimi me 2019

Buxheti për këtë periudhë ishte 11,720,086.23 €

Sic shihet nga tabela më lartë buxheti sipas SIMFK për janar- dhjetor 2020 është më i lartë për rreth 12.26 % se buxheti në periudhën e njëjtë të vitit 2019 .

1. Granti Qeveritar

Granti Qeveritar është burimi kryesorë i financimit të buxhetit komunal që shihet edhe në tabelë, ku pjesëmarrja është 88.92% në vitin 2020 (vlera 10,421,155.80). Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 13.4 % më i lartë. Nga kjo nënkuftohet se jemi të varur nga ky burim i financimit .

2. Të hyrat vetanake

Sic shihet edhe në tabelë buxheti nga THV të vitit 2020 është 915,074.00 € (7.80 % e buxhetit total në këtë periudhë) . Ndërsa në raport me vitin paraprak buxheti nga THV është më i ultë për rreth 20% . Të hyrat e bartura janë 361,621.56 € (3.08 % e buxhetit total në këtë periudhë). Në raport me vitin paraprak janë më të larta për rreth 20.9 %

3.Donacionet- Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit ,si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe donacionet e brendshme sic janë :

- Participimi i qytetarëve në vlerë 22,234.86 € (0.19 % e buxhetit total në këtë periudhë) , në raport me vitin paraprak buxheti nga participimet me qytetar është rreth 67 % më i lartë se në vitin paraprak . Buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2020 në vlerë 10,837,193.00 € është 92.47 % e buxhetit në SIMFK për vitin 2020. Nga Granti qeveritar 10,054.103.53 € (96.48% në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake 454,228.53 € (49.64 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2020) , nga të hyrat e bartura 323,013.20 € (89.32 % në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura) dhe nga participimi i qytetarëve 5,847.74 € (26.30% në raport me buxhetin nga participimet me qytetar. Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 10,837,193.00 € nga granti qeveritar janë 92.77% , nga të hyrat vetanake 4.19 % , nga të hyrat e bartura 2.98% dhe nga participimi i qytetarëve 0.05 % . Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të larta për rreth 7.24 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak . Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2020 në vlerë 10,837,193.00 € për paga dhe mëditje janë shpenzuar 6,288,922.81€ (58.03 % e shpenzimeve), përmallra dhe shërbime janë shpenzuar 1,573,368.75 € (14.52 % e shpenzimeve), për shërbime komunale 139,089.23 € (1.28 % e shpenzimeve), për subvencione 211,597.74 € (1.95 % e shpenzimeve) dhe për kapitale 2,624,214.47 € (24.21 % e shpenzimeve). Shpenzimet në periudhën janar– dhjetor 2020 në vlerë 10,837,193.00 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2019 në vlerë 10,105,743.54 € janë rritë për rreth rritë 7.24 % . Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë rritë rritë 5.64 % , shpenzimet përmallra dhe shërbime janë rritë rritë 53.41 %, shpenzimet për shërbime komunale janë zvogëluar për rreth 17.28 % , shpenzimet për subvencione janë rritë për 84.40 % dhe shpenzimet përkapitale janë zvogëluar për rreth 7.73 %. Arkëtimi i të hyrave sipas llojit për vitin 2020 dhe krahasimi me të hyrat e vitit 2019- Komuna ka të arkëtuara (inkasuar) gjithsej 986,325.58 € të hyrat vetanake, në periudhën janar – dhjetor 2020. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak të hyrat janë më të ulta për rreth 15.25 % ose në vlerë për 177,533.75 €.

SHPENZIMET BUXHETOKE PËR PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2020 DHE KRAHASIMI ME 2019- TOTALI PERGJITHSHEM 11,13,14,20,30.: Shpenzimet janar-dhjetor 2020-10,780,353.78. Shpenzimet janar-dhjetor 2019-10,105,743.54. Ndryshimi-674,610.24. Faleminderit të gjithëve për vëmendje.

Kryesuesi hap debat për raportin finansiar por asnjë nga anëtarët e Kuvendit nuk dëshiroj që ta merr fjalën.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Financa dhe Zhvillim për ndryshim të rregullores për taksa komunale.

Kryesuesi i kuvendit, z. Gashi theksoi se anëtarët e kuvendit e kanë shkresën nga drejtoria dhe sqarimin për nenin që i referohet drejtoria e FEZh dhe kërkon ndryshimin e tij. E lexon komplet shkresën e drejtorisë si dhe nenin që është kërkuar të ndryshohet. Bëhet fjalë për nenin 19 dhe pikën e fundit të këtij neni, ku drejtoria në fjalë si prova relevante për ankesat e bizneseve kërkon të merret vetëm prova nga zyra e regjistrimit të bizneseve kur obliguesi i taksave e shuan biznesin sipas procedurave të ligjit aplikativ për shuarje. Kurse prova nga ATK dhe inspektorati të shlyhet tërësisht.

z. Ajet Sejdiu, zyra e FEZh: Si zakonisht në bazë të rregullores ne i ngarkojmë me taksa obliguesit. Mirëpo ata kanë të drejt ankesë sipas ligjit. Si prova relevante ne i kemi përfshirë edhe formularët e ATK-së që i sjellin, me qarkullim ZERO dhe procesin e inspektoratit tonë. Si dhe shuarja e biznesit. Gjatë punës së përditshme dhe vendosjes për ankesat kemi hasur në probleme. Ka shumë obligues që i bishtnojnë taksave dhe kontabilistët e tyre e paraqesin në ATK zero qarkullimin. Kjo nuk është pasqyrë reale prandaj ne kemi konstatuar që me realja është që të merret si provë vetëm shlyerja e biznesit nga zyra e bizneseve bazuar mbi ligjin për shlyerjen e taksave. Për shkak të ekzistimit të këtij pasuesi në këtë nen, në një përballje në gjykatë me bizneset mund ta humbim.

Kryesuesi i kuvendit, z. Fadil Gashi, që kuvendarët ta kenë më të qartë këtë propozim i referohet nenit dhe paragrafit që u propozua të hiqet: Si prova formale, drejtoria përkatëse duhet të i pranoj siç vijon: - Vërtetimi i shlyerjes së biznesit nga zyra e bizneseve.-Raportin e ATK-së për qarkullimin e kontestuar dhe – Procesi i inspektorit komunal kompetent. Kërkesa është që të hiqet Raporti i ATK-së dhe Raporti i inspektorit. Dhe mbetet që si provë relevante të merret vetëm Shuarja e biznesit nga zyra e bizneseve.

z. Isa Ibishi: Përshëndetje kryesues, kryetar dhe gjithë të pranishëm. Mendoj që kjo kish me krijuar probleme veç më të mëdha se që janë aktualisht. Ka shumë biznese që janë të regjistruara por nuk funksionojnë. Ne e dimë që janë disa procedura goxha të vështira që të shlyhet një biznes. Mendoj që është interes i Komunës që provë për shlyerjen e biznesit të jetë deklarimi në ATK. Është i mirë propozimi i drejtorisë por jo të hiqen të tjerat. Të shtohet edhe kjo provë e propozuar.

z. Aziz Desku, drejtor i FEZH: Kemi dy raste ekstreme. Janë disa biznese që vërtetë nuk punojnë por kemi edhe një grup tjetër të bizneseve që punojnë çdo ditë, zhvillojnë aktivitet çdo ditë por deklarimin në ATK e kanë zero. Kjo pra është arsy që ne kemi bërë këtë propozim. Nuk është ligjore dhe nuk mund të mos i ngarkojmë me taksa bizneset që zhvillojnë aktivitet të përditshëm e të cila i ikin procedurave tatimore. Prandaj kemi menduar që është më mirë të hiqet fare një kriter që ne nuk mund ta kontrollojmë de të shtojmë një kusht tjetër që detyrimisht do të i bëjë bizneset më të përgjegjshme.

z. Isa Ibishi: Është mirë të shihet si mundësi deklarimi në ATK por si lloj kompromisi është mirë të shqyrtohet dhe shtohet që në momentin kur pala ankohet për shlyerjen e biznesit ta ketë kusht kërkesën për shlyerjen e biznesit.

z. Fadil Gashi, kryesues i Kuvendit: Ne nuk jemi duke bërë procedurë të re. Qysh po e shoh unë dy të fundit bijnë: Raporti i ATK dhe ai i inspektoratit. Te tjerat mbisin dhe i shtohet propozimi nga drejtoria. Iniciativa është me ndryshuar rregulloren tonë e jo ligjin.

z. Enver Berisha: Kërkesa që është bërë nga drejtoria e financave dhe kjo që na u tha tash nga drejtori po duket si një lloj dualizmi. Po flitet për bizneset që duan ti shlyejnë dhe për bizneset që janë aktive, zhvillojnë aktivitet dhe deklarojnë zero qarkullim. Tjetër. Unë nuk po shoh pengesë që të jetë edhe raporti i inspektoratit në vërtetimin nga zyra e biznesit për shuarje të biznesit. Përkundrazi raporti i inspektorit e ndihmon ashtu si nuk e pengon as raporti i ATK.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Unë më shumë e shoh si problematike lëshimin e kuponëve fiskal që nuk e bëjnë pothuajse asnjë ndërmarrje, prandaj ekonomistët e tyre e kanë shumë të lehtë që të deklarojnë zero qarkullim. Nëse duam të bëjmë shtet, inspektorët duhet të angazhohen. Unë kam një biznes në një vend ku kafen që e pipjë unë duhet ta shtyp kuponin. Për me funksionuar mirë duhet kjo të bëhet gjithsesi.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje të gjithëve. Dëshiroj të ndërlidhem shkurtimisht. Mirë është të merren për bazë propozimet që i bëri Isa Ibishi. Ne jemi të vetëdijshëm që për më hap një biznes e bëjmë për 5 minuta por për më myll një biznes janë shumë procedura të koklavitura. Prandaj ndoshta është mirë të merren për bazë propozimet që i bëri Isa dhe të përgatitet e të na sjellët në seancën e ardhshme.

z. Ajet Sejdiu, zyra e FEZH: Këtu bëhet fjalë vetëm për procedurën e shqyrtimit të ankesave. Në ATK nuk ke shanse pa u barazuar 00 që ta shlyesh biznesin. Ne me këtë propozim jemi duke jua lehtesar shlyerjen e biznesit. Është një provë relevante vërtetimi i shlyerjes së biznesit në rastin e vendosjes për ankesat. Inspektorët s' kanë mundësi që të i kontrollojnë të gjitha bizneset se a kanë qarkullim apo jo.

Kryesuesi theksoi se komisionit për ankesat i duhet kjo provë relevante siq e tha zyrtari. Edhe një herë për procesin: Si provë formale drejtoria kompetente duhet ta pranoj vërtetimin nga zyra për biznese për shlyerje të biznesit. Kush është për?

Me 25 vota për, një kundër dhe asnje abstenim U MIRATUA.

Pika e 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i dytë i kryetarit me qytetarë për vitin 2020

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së KKSB për vitin 2021

Me 26 vota për asnje kundër dhe asnje abstenim U MIRATUA

Pika 8 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Organogramit të Komunës për vitin 2021

Fjalën e merr drejtori i drejtorisë së Administratës

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Përvendetje për të gjithë. Gjashtë takime janë mbajtur për përpilimin e këtij Organogramit. Kanë marrë pjesë të gjithë akteret relevant nga Komuna në përgatitjen e këtij Organogrami. Nëse keni ndonjë propozim për ndryshim është mirë që të i jepni në mënyrë që të plotësojmë sa më shpejt

hapet debat

z. Fadil Gashi, kryesues: Unë kam biseduar edhe me drejtorin. Sekretaritë e Kuvendit sipas udhëzimit administrativ të pranuar me 30 shtator të nënshkruar, ato sekretari drejt për drejt kalojnë në Kuvend. Përgjegjësitë e sekretarive të kuvendit i bëjnë kryetari i Komunës bashkë me kryetarët e kuvendeve.

U Vendos në votim dhe me 26 vota për ,asnje kundër dhe asnje abstenim U MIRATUA

Pika 9 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2020.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përvendetje të gjithëve. Falënderoj drejtorin Aziz Desku që në detaje i dha të gjitha shifrat sa i përket qarkullimit financiar. Viti 2020 ishte vit i vështirë për shkak të pandemisë, për shkak të vonesave në aprovimin e buxhetit. Por koha ka qenë e mirë dhe kemi arritur që të bëjmë punë në realizimin e projekteve kapitale deri në fund të dhjetorit. Për mos me i përsëritë edhe një herë ato që i përmendi Azizi, mendoj që kemi kaluar një vit të vështirë me sfida dhe ajo që do të na shoqëroj ndoshta edhe gjatë këtij viti do të mbetët vetëm ajo pagesa përmbarimore. Me konsultimet që i kemi bërë me thesarin dhe me ministrinë e financave besoj që do të i tejkalojmë problematikat e bartura në këtë vit. Faleminderit shumë.

Hapet debat për raportin e punës për vitin 2020

Pika 10 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raporteve të komisionit për ndarjen e ndihmave gjatë pandemisë.

z. Gjokë Lleshaj: Faleminderit kryesues, përshëndetje për gjithë të pranishmit. Edhe pse e kam kërkuar unë dhe ka qenë zotim i juaji se do të sjellin raportet që janë edhe obligim ligjor, nuk ka ndodhë. Edhe kjo që keni sjellë nuk është komplete dhe nuk keni pasqyruar fakte. Kërkoj nga organet kompetente që të merren me këto raporte. Me vjen keq që nuk është komandanti i policisë këtu. Le të merret dikush me këto nëse ka shtet. Nëse nuk duan të merren këta as unë nuk do të merrem më shumë më këtë çështje.

z. Binak Sylaj, drejtor i administratës: Edhe pse jam i vetëdijshëm që rendin e ditës e formon kryesuesi me kryetarin dhe e miratojnë atë. Procedurat e formimit të komisionit të parë për ndarjen e ndihmave është formuar nga kryetari në kohën e fillimit të pandemisë. Ka punuar në kushte të vështira siç e dini situatën që ishte në mars të vitit 2020 kur Kлина ishte një nga Komunat e para që u fut në karantinë. Në atë kohë menjëherë është formuar dhe ka nisur të veproj shtabi i emergjencës. Me masat e marra nga kryetari dhe gjitha institucionet relevante përfshi edhe këtë kuvend, Kлина ka arrit që ta menaxhoj në mënyrë të shkëlqyer situate e krijuar. Duke qenë se Kлина ishte e izoluar nga qytetet e tjera, ky komision është marr me shpërndarjen e atyre ndihmave të pakta, një thes miell, dy kilogram kripë e një litër vaj. Në një kohë kur paniku të qytetarët ishte I madh se gjithashtu mundësia e furnizimit shumë e vështirë.

Zoti Sylaj në vazhdim bëri përshkrimin e detajuar të vështirësive që I kishin dalur komisionit duke filluar nga procedurat e tenderimit për artikuj ushqimor që kërkoheshin urgjent, mënyrës së organizuar përmes përfaqësuesve të fshatrave edhe pse këta përfaqësues nuk ishin legjitim, megjithatë kishin bërë një punë të madhe duke hartuar lista për nevojtarët. Gjithashtu ai theksoi se furnizime me këta artikuj ushqimor ju kanë dhënë edhe direkt njerëzve që janë lajmëruar në komision dhe kanë kërkuar ndihmë pa analizuar fare sepse ishte kohë pandemie, izolimi për të gjithë edhe për të varfrit edhe të pasurit. Askush nuk mund të dilte e të furnizohej e nevojat ishin pa dallim gjendjeje ekonomike familjare. Ai tha se komisioni I posedon të gjitha listat, të gjitha emrat dhe mbiemrat e përfituesve dhe të gjitha faturat e shpenzuara. Ai tha se I vjen keq të përmenden të gjitha emrat e atyre personave që janë 1632 e që kanë marr nga një pako në vlerë prej 13, 5 euro. Është material siç e shihni shumë voluminoz I marruar nga drejtoria e financave e të cilin material ka qenë e pa mundur që të jua shpërndajmë 27 anëtarëve të kuvendit por se të gjithë kanë pasur mundësi ta marrin e lexojnë. Tani duke e pasur parasysh gjithë këtë, të thuhet se janë keqpërdorë ndihmat më të vërtetë është pa kuptim, por po jua lë në ndërgjegje të gjithë atyre që thonë dhe mendojnë ashtu- përfundoj fjalën e tij drejtori I administratës, z. Binak Sylaj, pa harruar të falënderoj gjitha ata që vullnetarisht kanë ndihmuar me kamion dhe mjete të tjera. Për fund fare z. Sylaj theksoi se " Nëse din dikush nga ju që është marr apo është keqpërdorë qoftë edhe një rast I vetëm është mirë ta publikoni dhe jot ë përgjithësoni "

z. Gjokë Lleshaj: Gjerat më të thjeshta që kemi kërkuar ne s`ka. Edhe unë I falënderoj të gjitha ata që kanë ndihmuar por koleg I nderuar prej fillimi keni thënë se janë shpenzuar 19.900 euro dhe kanë përfituar 1200 familje, na e keni sjellë këtë listë edhe pse një pjesë e madhe janë future në listë si përfitues paushall pa përfituar hiq. Por kur na e keni sjellë raportin e parë nuk keni mundur me I arsyetuar me dokumente 1600 përfitues, pasi keni sjellë siç e thash listën vetëm për 1200. Mirë tash nëse janë shpenzuar ato mjetet që e thoni tash, a ka mundësi që edhe ne ti shohim listat, ta dimë kush janë këta përfitues?

z. Lleshaj në vazhdim të fjalës së tij përveç se kërkoj që të dihen lista për 1632 përfituesit ai kërkoj që të shohin arsyetimin e shpenzimeve për këta persona. Për më shumë z. Lleshaj theksoi se asnjë herë nuk është pajisur me dokumentet e kërkuar zyrtarisht nga komuna. Asnjë herë nuk i janë përgjigjur kërkeseve të tija për pajisje me informacione zyrtare. Ai insistoi që të gjithë anëtarët e Kuvendit të pajisen me listat e 1632 personave që kanë përfituar pasi që ato lista nuk i kanë. Ai në fund të fjalës së tij theksoi: Arsyetoni shpenzimet, prezantoni listat nëse i keni dhe jemi në rregull, nëse i keni por unë jam i sigurt që nuk i keni.

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Shumë e qartë, po dihet qasja dhe po shihet forma se si paraqitet kjo temë nga kolegu Lleshaj. Me përgjegjësi e them se as kryetarit dhe as kësaj asambleje, raport përfundimtar me 1200 emra nuk ju kemi dërguar. Raporti detal me 1632 persona është i paraqitur te kryetari i Komunës pasi që kryetari e ka themeluar atë komision. Me përgjegjësi të plotë e them se listat prej 1632 vetave janë të nënshkruara origjinal nga vet përfituesit. Mund të ndodhë që të jetë fshirë një emër e të jetë shkruar emri tjetër nga përfaqësuesit e fshatrave pasi që ka pas raste kur s` kanë dashur të marrin pakon e ndihmave dhe ju ka dhënë tjetër kujt. Nuk është mirë me e tjetërsuar procesin sepse asnjë keqpërdorim s` ka ndodhë. Nëse veç lëshohemi në këto çështje është mirë që kolegu Lleshaj të na raportoj edhe ai për komisionin e dytë që e ka themeluar kuvendi dhe ku ai ka qenë kryetar komisioni.

z. Fadil Gashi, kryesues: Është mirë që mos të merremi shumë më këto çështje ne si kuvend sepse do të duhej që të trajtonim çështje më madhore që janë në interes të qytetarëve dhe zhvillimit ekonomik e mos të humbim kohën duke diskutuar në këtë nivel. Edhe në seancën e kaluar edhe pse skam qenë prezent e kam dëgjuar drejtpërdrejt seancën dhe është debatuar shumë kjo çështje. Po bëhet temë e madhe pa pasur nevojë. Regjistrat mund të i keni nuk është shkelje që ti keni regjistrat e përfituesve por ashtu siç e kam thënë edhe më parë është shkelje të përmenden emra. Prandaj gjithsesi që mund të furnizoheni me regjistrat e kërkuar por përgjegjësinë për publikimin e tyre e mban ai që i publikon. Gjokë, kur është themeluar komisioni për ndarjen e dytë dhe e ke marr përgjegjësinë për të qenë kryetar i komisionit të kam thënë se ke me u pendua. E kam dijtë që ke me u penduar por se sa ka me zgjatë nuk e kam

dijtë. Në momentin kur ke deklaruar dorëheqjen nga kryetari i komisionit është dashtë bashkë me dorëheqjen ta deponosh edhe reportin e gjendjes së pranuar dhe të dorëzuar deri në atë moment. Nëse të pyesin tani se cili është numri i përfituesve që e ke lënë kur ke dhënë dorëheqje dhe sa mjete janë shpenzuar deri në atë moment, nuk besoj që e ke këtë numër, ndoshta gabohem, por nëse e ke unë të kërkoj falje me përulje. Dua të them se këto janë përgjegjësitë e një kryetari të komisionit në kësorastesh. Dua të them se të gjithë marrin përgjegjësitë e veta. Askush s' ta ndalon të drejtën që të tertiqesh në momentin që e shef që nuk shkon, s' po ke ndikim dhe të ka dalë jashtë kontolle situata por deri në atë moment përgjegjësinë duhet ta marrësh sikurse këta tjerët pas teje e ata para. Po them se mua më ke partner të drejtësisë kurdo që ta kërkosh ti apo të tjerët.

z. Esat Raci: Përshëndetje për të gjithë. Dëshiroj ti bëjë dy pyetje rreth çështjeve që i ngriti anëtarë i Kuvendit, z. Gjokë Lleshaj. 1. Nëse anëtarë i kuvendit ka kërkuar casje në dokumente zyrtar dhe nuk ju ka mundësuar, është shumë e pa pranueshme për mua ky veprim. 2. Gjoka po kërkon që mbulesa e përfituesve që është 1200 familjarë dhe shuma 19.000 euro a është e saktë? Këto janë dy pyetje të mia konkrete.

z. Fadil Gashi, kryesues: Asnjëren nga këto pyetje nuk i dijë. Nuk është puna e ime që ti dijë.

z. Gjokë Lleshaj: Nuk e kam kërkuar vetëm këtë raport por edhe reportin kur kam qenë unë kryetar Komisioni...

z. Gjokë Lleshaj vazhdoj tutje me vërejtjet e tija rreth shpërndarjeve të ndihmave edhe nga komisioni i dytë dhe theksoi se reportin para se të jap dorëheqje ja ka dorëzuar drejtorit të Financave. Në këtë debat u kyqen edhe anëtarët e tjerë të Kuvendit ; z. Xhevxhet Berisha, Valmir Bacaj, Esat Raci, Sefa Morina, Asdren Ramadani, Tunë Dedaj, Kryesuesi, Fadil Gashi, kryetari, Zenun Elezaj, drejtori, Binak Sylaj etj. Kryetari i Komunës kërkoi nga drejtori i administratës që komplet lista e shfrytëzuesve të ndihmave të bëhet kopje dhe të i epet anëtarit të Kuvendit, z. Gjokë Lleshaj. Ai kërkoi në fund që nëse dikush ka ndonjë element a fakte që dikush ka bërë keqpërdorime, ato duhet të i deponoj në organet kompetente. Kryetari i Komunës gjithashtu propozoj që për ta sqaruar më mirë këtë lëndë të bëhet një auditim i kësaj lënde nga auditori i brendshëm dhe në seancat e ardhshme të na sjellët një raport. Duke konstatuar që kjo temë është konsumuar tepër shumë dhe duke kërkuar mirëkuptimin e anëtarëve të kuvendit që ta mbyllim si pikë.

Kryesuesi bëri përmbylljen e propozimit të kryetarit që auditori i brendshëm të bëjë një auditim në bashkëpunim me komisionet që kanë bërë ndarjen e ndihmave dhe rapporti i auditorit të na sjellët në kuvend.

Pika 11 e Rendit të Ditës: Rishqyrtimi i vendimeve me nr. 01nr.06-8940/2020 dhe 01 nr. 06-15082/2020

Kryesuesi theksoi se ai personalisht nuk do të jetë pjesë e vendim marrjes. Konstatoi se për këtë çështje Komuna është në gjykatë dhe se prokurori e ka marr lenden komplet. E kemi konsumuar këtë punë dhe s’di çka të them më shumë. Unë jam ashtu siç vendosë Kuvendi. Kam kërkuar nga kryetari që të kemi një interpretim ligjor nga zyra ligjore e Komunës. Këtë interpretim ju e keni gjithashtu. Licencat operatori i ka marr e ne kemi mbetur duke i sjellë shkresat mes komunës dhe ministrisë. Ne si komunë kemi respektuar një procedurë bazuar në një peticion të qytetarëve, kemi marr një vendim. Kam biseduar me ushtruesin e detyrës së sekretarit në Ministri dhe ai nuk mundet me e arsyetuar. Gjitha shkresat gati i dërgojnë pas afatit ligjor që janë të obliguar të kthejnë përgjigjen. Gjendja është e tillë tani, bordi atje në Prishtinë është shpërnda, kompania ka marr licencat dhe ne prap cilin do vendim që ta marrim sot do të detyrohem që ta dërgojmë në ministrinë e linjës për konfirmim të ligjshmërisë. Shkresat i keni, vendimet i keni përballë, mendimin e zyrës ligjore e keni gjithashtu. Si do që të vendosni ju nuk keni asnje përgjegjësi pasi që e keni mendimin e zyrës ligjore për këtë çështje.

z. Enver Berisha: Nuk është hera e parë që ky kuvend sfidohet nga mos veprimet e nivelit qendror. Kësaj radhe e kemi sfiduar paksa veten pasi që kemi marr një vendim bazuar në një peticion të nënshkruar nga mbi 4000 qytetarë. Kemi nxjerr një vendim mbi këtë e duke u këshilluar me zyrën ligjore etj. Ne nuk jemi kompetent të interpretimeve ligjore prandaj sjellja e jonë në këtë situatë është e pa drejt dhe është lajthitje që i bëhet kësaj asambleje. Edhe në kohën kur kemi marr vendim ka pasur zëra që ne nuk und të i ndalojmë me atë vendim, megjithatë duke ju referuar instancave me kompetencë ligjore kemi vendosur. Prandaj duke përfshi veten time dhe grupin tim kuvendar, duke dashur që të marrim vendime kolegiale, ndonjë herë po bëhem pjesë e vendimeve që realisht ju takojnë Pozitës. Megjithëkëtë ne jemi këtu që me aq sa kemi kompetencë, vendimet tona të i mbrojmë.

z. Arben Limanaj: Ne si asamble ndoshta jemi gjendur përballë një presioni të arsyeshëm nga banorët e atij lokacioni ku është menduar të ndërtohet fabrika e cimentos. Ndryshe nga kjo ndoshta është dashur që edhe peticioni i drejtuar neve të i drejtohet edhe nivelit qendror. Mendoj që shefat e grupeve të konsultohen edhe një herë para se të vendosim sot.

z. Enver Berisha: Para se me ardhë të kjo që po thotë z. Arben Limanaj, do të doja që zyra ligjore të prezantoj edhe një herë këtu para kuvendit dhe më pastaj të takohemi përkonsultime.

z. Fadil Gashi, kryesues: Interpretimin e zyrës ligjore e keni të shkruar. Mendoj që kemi shteruar gjitha debatet për këtë çështje. Neve për vendimin tonë na kanë dërguar në gjykatë. Kuvendi nuk ka bërë asnje shkelje. Gjitha njoftimet i ka dërguar me kohë në ministri. Nuk e diji çka mund të kontribuojmë më shumë- ne mund të flasim kot, të shkëmbejmë opinione kot, letra sepse kompania ka marr licencat për veprimitari.

z. Petrit Palushaj: Ne si Aleancë jemi dakord që të takohen shefat e grupeve dhe të marrim një vendim të gjithë bashkë ashtu siç e kemi marruar vendimin atëherë. Sido që të jetë vendimi që do të marrim, le të jetë vendim i përbashkët.

z. Enver Berisha: Zyra ligjore është mirë të vije këtu dhe të bëjë një interpretim edhe një herë për shkak të opinionit publik dhe për anëtarët e Kuvendit.

z. Driton Raci, zyra ligjore: Përshëndetje të gjithëve. Fillimi shqiptar i njoftojmë se zyra ligjore nuk është organ kompetent për interpretim të shkresave apo akteve të Ministrisë së Pushtetit Lokal, Ministrisë së Ekonomisë dhe ambientit apo ministreve të tjera. Interpretimin autentik të aktit e bënë organi I cili e nxjerr vetë aktin, I cili në rast të paqartësive ia jep domethënien e drejtë të aktit. Duke u bazuar në dispozitat e ligjit për vetëqeverisje lokale, Nr. 03/L-040, është e qartë se autoriteti mbikëqyrës komunave është Ministria për qeverisje lokale, në rastin konkret MPL, e cila në bashkëpunim dhe koordinim me ministrinë e linjës bënë shqyrtimin e rregullt dhe të detyrueshëm të ligjshmërisë së akteve të Komunës. Duke u bazuar në shkresën e MPL-së të datës 18. 01. 2021 si dhe shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe ambientit të datës 12. 01. 2021 sipas cilës Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit si ministri kompetente përvlerësimin e ligjshmërisë së akteve të Komunës së Klinës, ka ardhur në perfundim se Vendimi I Kuvendit të Komunës së Klinës , 01. Nr. 06-8940/2020 I datës 11. 03. 2020 si dhe vendimi I Kuvendit të Komunës 01 Nr. 06-15082/2020 I datës 02. 07. 2020 nuk mund të prodhojnë efekte juridike pasi që janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Përveç kësaj është theksuar se vendimet e tillë të Kuvendit të Komunës nuk janë në harmoni me dispozitat e ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, respektivisht neni 53 paragrafi 1, sipas të cilit nen thuhet se, citojmë: " Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet sipas detyrës zyrtare nga organi publik që ka kompetenca të nxjerr aktin, nga organi I tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër I përcaktuar shprehimisht me ligj." Mbi bazën e përgjegjësisë për shqyrtimin e ligjshmërisë që e ka dhënë MPL-ja me datën 18. 01. 2021 e këtë paraprakisht e kishte nxjerrë mbi bazën e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, të datës 12. 01. 2021, ka kërkuar nga Kuvendi I Komunës së Klinës që sipas nenit 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje Lokale, që të shqyrtohen aktet në fjalë. Mbi këtë gjendje mendojmë se Kuvendi I Komunës së Klinës duhet të veproj në përputhje me shkresat e lartpërmendura të Ministreve përgjegjëse duke rishqyrtuar vendimet e tillë me qellim të anulimit të tyre.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne si kuvend e kryejmë punën kur e qesim në rishqyrtim ashtu siç ka kërkuar Ministria e linjës. Cili do të jetë vendimi i marruar është tjetër gjë. Vendimin nuk e determinon Ministria në fjalë.

z. Gjokë Lleshaj: Shumë gjera u sqaruan këtu. Në një farë forme u dakorua që shefat e grupeve të dakordohen. Unë qëndroj pas vendimit të marruar atëherë. Sa herë të duan e rishqytojmë por qëndrimi im mbetet i pa ndryshuar.

- z. Enver Berisha:** Në bazë të kësaj që ju e thatë në fund dhe në bazë të asaj q e lexoj zyrtari Raci. Këtu është kërkuar që të shfuqizohen vendimet e marruar. Kërkoi që të jemi të dakorduar të gjithë dhe të marrim një vendim të përbashkët cili do qoftë ai. Zyra ligjore nuk e sqaroj siç duhet tani. Kjo zyre e ka dhënë një interpretim në kohën kur kemi marr vendim. Dhe e fundit, kryesues, pse ju nuk jeni pjesë e vendim marjes?
- z. Fadil Gashi, kryesues:** Nuk mund të jem, as atëherë skam qenë sepse është fjala përfshatin Qupevë verilindore- vendlindjen time dhe nuk dua të bëjë konflikt interesit.
- z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Nga zyra ligjore kemi kërkuar zërthim të asaj shkresë të Ministrisë e cila shumë qartë thotë se vendimi i jonë nuk prodhon efekt juridik. Ne nuk mund ta fusim në funksion atë vendim të marruar në Kuvend. Zyra ligjore veç na e ka zërthyje problemin siç kemi kërkuar nga ta. Ndërsa përgjegjësia është e Ministrisë së linjës ashtu siç është edhe përgjegjësia e interpretimit.
- z. Fadil Gashi, kryesues:** Ministria na e ka kthyer për rishqyrtimi vendimin që d.m.th. se këtë vendim tonin nuk mundet me na e heq Ministria, këtë vendim mundet vetëm gjykata. Çështja është se shumë është debatuar për këtë çështje, kemi shkëmbyer shumë shkresa. Tani lënda është në gjykatë, prokurori ka marr shkresat dhe Kompania ka marr licencat. Ministria që na e ka dërguar këtë shkresë, vet ajo na ka quar në gjykatë. Kemi interpretimin e zyrës ligjore dhe për ua cili do vendim që merret këtu është i pranueshëm.
- z. Valmir Bacaj:** Ne e dimë që të gjitha subjektit politike që jemi në këtë kuvend kemi qenë kundër ndërtimit të fabrikës së çimentos. Më intereson një mendim i zyrës ligjore se cilat janë pasojat tona nëse ne insistojmë që të qëndrojmë pranë vendimit tonë?
- z. Zenun Elezaj, kryetar:** Ekzekutivi është në hall të madh. Ne jua kemi kthyer negative duke u munduar të ju themi se nuk jemi kompetent për vendimin për ndërtimin e fabrikës së çimentos ndërsa ata na e kanë kthyer që ju jeni përgjegjës për këtë vendim. Prandaj vendimi i juaj është determinues. Ndoshta është dashur që para se të merr vendim asambleja të dërgohet në ministri të linjës një draft vendim dhe të konsultohet ministria. Unë nuk e kam pasur atë përvojë është dashur ata që e kanë pasur përvojën e tillë.
- z. Esat Raci:** Unë propozoj që të mbetemi pranë vendimit të më pashëm derisa lënda është në gjykatë. Pra të qëndrojmë pranë vendimit tonë të marruar derisa organi – gjykata të vendosë. Kjo është edhe e përafërt me ministrinë e linjës.
- z. Fadil Gashi, kryesues:** Nuk mendoj që janë të përafërt sepse ministria po kërkon shfuqizimin e vendimit tonë. Ekzekutivi tani e ka problem të lëshoj kushtet ndërtimore pa e tërheq ne vendimin tonë.
- z. Zenun Elezaj, kryetar:** Është në dorën e juaj me vendosë. Por ndoshta Dritoni është mirë të përgjigjet në pyetjen e Valmirit sepse është shumë më rendësi. Ministria ka kërkuar rishqyrtim nuk thotë anulojeni, çka nëse ne mbesim pranë vendimit tonë përsëri, prap do të na dërgojnë në gjykatë- dy herë në gjykatë.

z. Driton Raci, zyra ligjore: Ministria MPL, ka konstatuar se vendimi i parë dhe i dyti nuk mund të prodhoj efekte juridike sepse janë në kundërshtim me ligjin. Prandaj ajo kërkon që organi që ka marr vendim të rishqyrtoj vendimet e marruar. Me vetë faktin që është konstatuar që është në kundërshtim me ligjin d.m.th. që është kërkuar të vendoset ndryshe nga ai vendim.

z. Raci ju përgjigj pyetjes së Kryetarit i cili e pyet për një konfirmim të ardhur dje e që është i pas kohëshëm, a duhet të tërhiqemi nga procedurat tona tani edhe pse janë publikuar vendimet? Ndërsa përgjigja e zyrtarit ligjor është se vonesat në përgjigjet e ministrisë i shpjegojnë e arsyetojnë ata, ne nuk jemi kompetent. Ndërsa kryesuesi i kuvendit edhe një herë e shpjegoj procedurën e dërgimit të akteve të kuvendit për shqyrtim të ligjshmërisë, afatet që sipas ligjit e rregulloreve në fuqi janë në dispozicion të ministrive dhe të tjera procedura.

z. Enver Berisha: Nëse përgjigja ka qenë tepër e vonuar dhe nga ky aspekt ka mbetur edhe lënda pa u rishqyrtuar këtu, a është ky rezultati që enda është në gjykatë- mos përgjigja e ministrisë me kohë dhe mos reagimi i jonë në bazë të kësaj vonese. Dhe e fundit- thuhet që vendimi i ynë nuk prodhon efekt juridik- çka d.m.th. kjo?

z. Driton Raci, zyra ligjore: Në këtë rast, vendimi i kuvendit nuk mund të prodhoj efekt juridik sepse kuvendi ka marr një vendim që nuk është kompetencë e tij por e drejtorisë së urbanizimit.

z. Tunë Dedaj: Kërkesa e ministrisë është që të shfuqizojmë vendimin që kemi marruar ne. A dojmë ne me e shfuqizuar, apo të qëndrojmë mbrapa tij dhe ti përkrahim qytetarët, këtë duhet ta marrim ne si asamble.

z. Tush Dedaj: Përshëndetje. Kur kemi pas biseduar kam pas thënë që jemi marionetë dhe krejt tastet i lëvizë dikush tjetër. Nëse tani ne lëshojmë pe atëherë me të vërtetë jemi marionetë dhe nuk do të jemi në përkrahje të qytetarëve. Të kemi kujdes me qytetarët sepse ne jemi përfaqësues të tyre.

z. Fadil Gashi, kryesues: Atëherë e ke pas thënë në një kontest tjetër fjalën Marionetë. Por po them se s`kemi nevojë të jemi marionetë e askujt. Për veprimet tona japim llogari para gjitha organeve dhe para qytetarëve gjithsesi. Tani ose do të votojmë kundër ligjit ose kundër petcionit të qytetarëve.

Kryesuesi e qet në votim shkresën e ministrisë që kërkon anulimin e vendimit Për asnjë, kundër asnjë, abstenim 26 anëtarë të kuvendit.

Pika 12 e Rendit të Ditës: Shpallja zonë e interesit të veçantë për zonën nr. Sipas kërkesës së drejtorisë së Shërbimeve Publike.

z. Esat Raci: Në cilin projekt për ujësjellës hynë fshati Resnik?

z. Ibër Elezi, drejtor i SHP: Fshati Resnik hyn po në këtë projekt por momentalisht nuk është pjesë e projektit. Por bashkë me "Hidrodrinin" do të angazhohemi pasi që fshati në fjalë e ka rrjetin e shtrirë dhe të kyqet më pastaj. Veç edhe një sqarim për këtë zonë. Parcela në fjalë mund të jetë më e madhe se sa që na duhet neve për projektin, prandaj pas matjeve në teren, ekipi i ingjinierve e përcakton hapësirën e nevojshme që përafërsisht duhet të jetë 2000 deri në 3000 metra katrore.

Kryesuesi e nxjerr në votim dhe me 25 vota Për, asnë kundër dheasnë abstenim U MIRATUA.

Pika 13 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje

z. Tunë Dedaj: Dola në foltore që të shpreh një shqetësim të qytetarëve të Klinës për sjelljen e disa policëve të stacionit në Klinë të cilët nuk zbatojnë barabartë ligjin për të gjithë kur është fjalë për mos mbajtjen e maskave. Dike e falin dike e dënojnë e dike e shtrijnë për toke. Kërkoi nga komandanti i policisë që të merren masa.

z. Asdren Ramadani: Pyetje për kryetarin. Nga vërvshimet fundit është shkatërruar tèresisht ura në Rastoka. Kur do të i bëhet zgjidhja këtyre banorëve të këtij fshati?

z. Zenun Elezaj, kryetar: Brenda javës së ardhshme mendoj që do të fillojnë procedurat. Me meremetime nuk po bëhet asnë zgjidhje prandaj duhet të shkojmë me një urë të re.

Znj. Mendehije Duraku: Përshëndetje për të gjithë. Kam një pyetje për kryetarin. Deri ku kanë shkuar punimet për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve në fshatin Deiq. Dhe kur është paraparë të përfundoj ky projekt?

z. Zenun Elezaj, kryetar: Është një shqetësim yni sepse projektet investive që bëhen nga Ministria e Arsimit asnë element nuk është nga ne, edhe mbikyerjen e kanë ata. Ne synojmë që nga fundi i vitit të kemi të ndërtuar atë objekt.


z. Zeqir Morina: Përshëndetje. Dola të potencoi dy çështje. Në lumin Kлина shtrati është ndërtuar me gurë dhe gjatë këtyre vërvshimeve kam parë që në tre vende është dëmtuar. A jeni në dijeni? E dyta, në fillim të këtij mandati e kam përmendur dy herë shkarkimin e ujërave të zeza në Stapanicë dhe në Rixhevë. Bashkohen ujërat e zeza dhe krijojnë një gjendje shumë të keqe. Propozoj që të shkohet atje dhe të shikojnë gjendjen se a duhet marruar apo jo ndonjë veprim.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Lumin- shtratin e lumbit e kanë dëmtuar të reshurat e mëdha. Këtë vit ne do të jemi në fazën përgatitore sepse kemi nga Ministria 100 mijë euro për shtratin e lumbit. Po ashtu do të kemi një fond për pastrimin e lumenjve dhe ne do ta realizojmë këtë. Për impiantin në Stapanicë e kemi diskutuar bashkë me Komunën e Malishevës pasi që janë fondet për bash punimin nder komunal dhe besoj që bashkërisht këtë vit do të bëjmë zgjidhjen e duhur për ato fshatra.

- z. Gjokë Lleshaj:** Kanalizimin në leskoc a jeni në dijeni që vërshimet e kanë shkatërruar dhe e dyta Ujë i pijshëm kur pritet të ketë në lugun e Drinit?
- z. Lorenc Marleku, drejtor i Urbanizmit:** Po ke të drejt, kanalizimi është shkatërruar nga vërshimet. Ne kemi një komision por aty nuk und të punohet edhe 10-15 ditë pasi që ka shumë ujë dhe nuk mund të futet operatori. Deri nga mesi i Marsit do të i evitojmë defektet e bëra nga vërshimet.
- z. Zenun Elezaj, kryetar:** Për fshatin Stupë ka pasur që të lëshohet uji i pijshëm këtë javë, është shtrirë rrejti nga projekti i CDI, uji do të merret nga Peja. Faza e dytë kërkon vetëm edhe një miratim nga Kuvendi i Kosovës, linja Budisalcë, Jagodë, Krushevë dhe fshatrat e tjera. Këtë vit CDI do të vazhdojë fazën e dytë- 400 mijë euro. Do të na mbetet pak anash vetëm Leskoci dhe Ranoci , jemi duke zhvilluar bisedime me Istogun përmes Koshit, Bisedimet ende s' kemi arritë që të i finalizojmë , por nuk kemi akoma konfirmim final.

Me këtë pikë të rendit të ditës përfunduan punimet e seancës së rregullt të punës së Kuvendit të Komunës së Klinës. Kryesuesi falënderoj të gjithë për angazhimin dhe kontributin e dhënë.

Procesmbajtës:
Skënder Behramaj




Kryesuesi:
Fadil Gashi